

VENDIM
Nr. 818, datë 21.10.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE NË SHKOLLËN “KOSOVA”, NË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i terreneve sportive në shkollën “Kosova”, në Tiranë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, prone private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë 76 213 135 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 76 213 135 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Tiranë.
 8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE NË "SHKOLLËN KOSOVA", NË TIRANË

Nr.	EMËR ATËSI MBIEMËR	Z. K.	NR. Pas.	SIP. Përgj. Truall (m²)	SIP. Prekur Truall (m²)	Çmimi për Truall (lekë/m²)	VLERA truall i prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së Objektit sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. Ndërtimi e Objektit sipas kartelës (m²)	Sip. prekur Objekt (m²)		ÇMIMI Objekt banimi (lekë/m²)	VLERA sip. prekur Objekt, shërbimi, me situacion (lekë)	VLERA sip. prekur Objekt banimi (lekë)	VLERA E Përgj. truall + objekt (lekë)	KONFIRMIM ASHK TIRANË	SHËNIME
										Sip. Shërbimi (m²)	Sip. Banimi (m²)						
1	BP. Tagani (Kimete Mehmet Tagani, Arben Sami Tagani, Xhelal Sami Tagani)	8160	2/330-ND	0	0	-	-	110.00	330.00	0.00	330.00	172,198.82	0.00	56,825,609.12	56,825,609.1	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në kartelën e pasurisë, seksioni "Përshkrimi i veçantë" ka shënimin "Objekt 3 kat", dhe në seksionin "E" ka shënimin "Ndërtesa ngrihet mbi truallin me nr. pasurie 2/330, vol. 47, fq. 203"
2	Pronar i pa vërtetuar	8160	2/330	234.5	234.5	66,969	15,704,230.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	15,704,230.5 0	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E" ka shënimin "Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa me nr. pasurie ND- 2/330, vol. 49, fq. 96"
3	BP. Tagani, Saraçi	8160	2/165	36	36	66,969	2,410,884.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	2,410,884.00	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.09.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
4	Bashkia Tiranë	8160	2/76	2468.5	10	-	-	748.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
5	Artan Ferid Tagani	8160	2/331	66.5	19	66,969	1,272,411.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	1,272,411.00	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
6	Shtet	8160	2/319	242	28	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 966/1, datë 19.05.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Shesh
7	Shtet	8160	2/91	893	4	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.09.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Trotuarë
SHUMA PARAPRAKE					331.5										76,213,135		

SHËNIM:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, Konfirmohen me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.09.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, nr. prot. 966/1, datë 19.05.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 05.06.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.
2. Për tuallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt. 03.02.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 58091/1, datë 05.06.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.
4. Pasuria nr. 2/287, z.k. 8160, në pronësi të bashkëpronarëve Ulqinaku dhe Shahu, e cila preket nga projekti, është hequr nga tabela e llogaritjeve paraprake, pasi në shkresën nr. prot. 966/1, datë 19.05.2020, të ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug konfirmohet pasuri e menaxhuar me leje zhvillimore, në favor të shoqërisë "DAJTI FN".